

MBROJTJA E KADRI VESELIT DHE REXHEP SELIMIT PARAQESIN DEKLARATAT PËRMBYLLËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

MBROJTJA E VESELIT DHE SELIMIT SHKËRMOQIN PRETENDIMET E ZPS-së

FAQE 4-5

-Avokati Dixon: Kadri Veseli duhet të lirohet dhe të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat

-Avokati Roberts: Rexhep Selimi është tërësisht i pafajshëm. ZPS-ja s'ka rritur t'i provojë akuzat

Mbrojtja e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ajo e ish-deputetit Rexhep Selimi, kanë paraqitur deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë ndaj liderëve të UÇK-së. Avokati Rodney Dixon, ka thënë se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë të vërtetuar kundër Veselit. Duke adresuar një mori kritikash kundër ZPS-së, Dixon ka thënë se disa dëshmitarë kanë gënjyer nën betim. Ai ka akuzuar ZPS-në se ka ofruar dëshmi të paverifikuara. Në këtë kontekst, ai ka kërkuar nga trupi gjyqësor që të ketë kujdes nga dëshmitë që ZPS-ja ka marrë nga Serbia. Edhe avokati i Selimit, Geoffrey Roberts, ka thënë se klienti i tij është tërësisht i pafajshëm. Roberts i ka thënë trupit gjyqësor se ZPS-ja nuk ka arritur të provojë asnjë prej akuzave të saj



KUVENDI I SHOIPËRISË MIRATON DEKLARATË PËR PAFAJËSINË E UDHËHEQËSVE TË UÇK-së

F. 8



OSMANI ANULON SHKUARJEN NË MUNIH, KURTI SINJALIZON GATISHMËRINË PËR DISKUTIME PËR PRESIDENTIN

F. 3



SHUMICA E BANORËVE NË KOSOVË JETOJNË NË BANESA NË PRONËSI

F. 8

SPORT



ADEMI MERR PJESË NË KONGRESIN E 50-TË TË UEFA-S: U MORËN VENDIME TË RËNDËSISHME PËR FUTBOLLIN

F. 11

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht -Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA

GROUP SH.P.K.

NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com

Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

KOLEGJI BIZNESI

KB

Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878

SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

KUVENDI I SHQIPËRISË MIRATON DEKLARATË PËR PAFAJËSINË E UDHËHEQËSVE TË UÇK-së

Në këtë deklaratë për pafajësinë e udhëheqësve të UÇK-së, e cila mori 92 vota pro, thuhet se Kuvendi i Shqipërisë, duke mbajtur parasysh të vërtetën historike të luftës çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës, rithekson se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një lëvizje legjitime çlirimtare që luftoi për të drejtat themelore të njeriut, për liri, dinjitet dhe vetëvendosje të popullit të Kosovës, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

TIRANË, 12 SHKURT - Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar të enjten me 92 vota pro deklaratën për pafajësinë e udhëheqësve të UÇK-së. “Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në ushtrimin e kompetencave të veta kushtetuese dhe në përmbushje të rolit të vet si përfaqësues i vullnetit të popullit shqiptar, shpreh shqetësimin e thellë për kërkesën përfundimtare të Prokurorisë Speciale të Dhomave të Specializuara në Hagë ndaj drejtuesve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Kuvendi i Shqipërisë, duke mbajtur parasysh të vërtetën historike të luftës çlirimtare të shqiptarëve të Kosovës, rithekson se Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte një lëvizje legjitime çlirimtare që luftoi për të drejtat themelore të njeriut, për liri, dinjitet dhe

vetëvendosje të popullit të Kosovës, në përputhje me parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe Kartës së Kombeve të Bashkuara. Kuvendi vëren me shqetësim se kërkesa e Prokurorisë Speciale rrezikon të krijojë një shtrembërim të rrezikshëm të historisë, duke barazuar luftën legjitime të një populli për mbijetesë dhe liri me krimet e regjimit serb të Millosheviqit, i cili kreu spastrim etnik dhe krime kundër njerëzimit ndaj popullit të Kosovës. Për këtë, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë deklaron: 1. Mbështetjen e plotë dhe të pakushtëzuar për drejtuesit e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të cilët ishin dhe mbeten përfaqësues të aspiratave të drejta të popullit të Kosovës për liri dhe vetëvendosje. Lufta e tyre ishte luftë e drejtë, e mbështetur në parimet universale të të drejtave të njeriut. 2. Kërkesën drejtuar Dhomave të Specializuara në Hagë, komunitetit

ndërkombëtar dhe institucioneve të drejtësisë ndërkombëtare që të deklarojnë pafajësinë e Hashim Thaçit, Jakup Krasniqit, Kadri Veselit dhe Rexhep Selimit përmes një procesi të drejtë dhe të paanshëm, që respekton dhe nuk cënon dinjitetin e luftës çlirimtare të popullit të Kosovës, duke mos lejuar që instrumentet e drejtësisë të shndërrohen në mjete për rishkrimin e historisë apo për barazimin e viktimës me agresorin. 3. Kujtimin ndaj bashkësisë ndërkombëtare se lufta e UÇK-së u zhvillua në kushtet kur regjimi i Millosheviqit po kryente spastrim etnik, krime sistematike kundër njerëzimit dhe akte genocidiale ndaj popullatës civile të Kosovës, dhe se ndërhyrja e NATO-s në vitin 1999 konfirmoi legjitimitetin e asaj lufte dhe natyrën kriminale të regjimit të

Millosheviqit. 4. Vlerësimin e lartë për dëshmitarët ndërkombëtarë të mbrojtjes, si Wesley Clark e James Rubin, të cilët konfirmuan të drejtën e popullit të Kosovës dhe udhëheqësve të tyre për liri. 5. Solidaritetin e plotë me popullin e Kosovës dhe me familjet e drejtuesve të UÇK-së, duke rithekson se kombi shqiptar qëndron i bashkuar në mbrojtjen e të vërtetës historike dhe të dinjitetit të luftës për liri. 6. Angazhimin për të ndërmarrë çdo hap të nevojshëm diplomatik dhe politik në forume ndërkombëtare për të siguruar që e vërteta historike mbi luftën çlirimtare të Kosovës të mos cenohet dhe që drejtësia të ushtrohet në mënyrë të drejtë. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u bën thirrje institucioneve të shtetit Shqiptar, institucioneve të Republikës së Kosovës dhe diasporës shqiptare që të

qëndrojnë të bashkuar në mbrojtjen e së vërtetës, dinjitetit dhe drejtësisë për popullin e Kosovës dhe për drejtuesit e luftës së tyre çlirimtare, Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Kadri Veseli dhe Rexhep Selimi. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë u rekomandon qeverive të Republikës së Shqipërisë dhe të Republikës së Kosovës të bashkëpunojnë dhe koordinojnë për denoncimin ndërkombëtar të krimeve serbe. Kjo deklaratë pasqyron vullnetin unanim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe i transmetohet Dhomave të Specializuara në Hagë, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, Parlamentit Evropian, Asambleve Parlamentare të NATO-s, OSBE-së dhe Këshillit të Evropës, si dhe të gjitha qeverive mike dhe partnere”, thuhet në deklaratën e përbashkët mes palëve politike në Kuvendin e Shqipërisë.

NATO-JA NIS MISIONIN ROJA E ARKTIKUT

BRUKSEL, 12 SHKURT - NATO-ja e ka nisur zyrtarisht misionin Roja e Arktikut, me qëllim që të përmirësojë pozicionin ushtarak të aleancës në rajonin e Arktikut.

Kjo lëvizje vjen pas tensioneve të fundit mes aleatëve të NATO-s, Danimarkës dhe Shteteve të Bashkuara, lidhur me të ardhmen politike të Grenlandës. Kur u përmend për herë të parë muajin e kaluar, disa diplomatë i thanë Radios Evropa e Lirë se një mision i mundshëm në Arktik mund të ishte një rrugëdalje nga një krizë në rritje.

Pas një takimi ndërmjet presidentit të SHBA-së, Donald Trump, dhe sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, muajin e kaluar në Davos të Zvicrës, u ra dakord që NATO-ja të luajë një rol më të madh rreth Grenlandës, për të zmburësuar ndërhyrjet e mundshme kineze dhe ruse



rreth ishullit dhe në Arktik në përgjithësi.

Gjatë një konference për media në Bruksel më 11 shkurt, Rutte tha se “për herë të parë do ta sjellim nën një komandë të vetme gjithçka që bëjmë në Arktik. Jo vetëm që do t'i shfrytëzojmë të gjitha kapacitetet që kemi, por do të shohim edhe se cilat janë

boshllëqet dhe do t'i mbushim ato”, duke shtuar se “këtë e bëjmë sepse kemi një ndjenjë të qartë se rusët dhe kinezët po bëhen gjithnjë e më aktivë atje”. Në një komunikatë për media lidhur me nisjen e misionit, komandanti suprem i forcave aleate të NATO-s për Evropë, Alexis Grynkeuich, tha se “Roja a Arktikut vë në pah

përkushtimin e aleancës për të mbrojtur anëtarët e saj dhe për të ruajtur stabilitetin në një nga zonat që në aspektin strategjik janë më të rëndësishme dhe më sfiduese nga aspekti mjedisor në botë”, duke shtuar se misioni do të “shfrytëzojë fuqinë e NATO-s për të mbrojtur territorin tonë dhe për të siguruar që Arktiku dhe Veriu i Lartë të mbeten të sigurt”.

Deri më tani nuk janë publikuar detaje se sa shtete të NATO-s janë të përfshira në mision apo edhe për nivelin e trupave, edhe pse aleanca ushtarake perëndimore ka konfirmuar se misioni është “shumëdimensional”, që nënkupton se do të përfshijë ajrin, detin dhe tokën. NATO ka bërë gjithashtu të ditur se stërvitja Qëndresa e Arktikut e Danimarkës, së bashku me 11 vende të tjera evropiane anëtare të NATO-s që po zhvillohet aktualisht në dhe përreth Grenlandës, si dhe stërvitja e

ardhshme e titulluar Përgjigja e Akullit në veri të Norvegjisë dhe Finlandës, që përfshin 25.000 ushtarë, përfshirë trupa amerikane, do të jenë pjesë e misionit Roja e Arktikut.

Shtatë nga tetë vendet e quajtura “arktike” janë anëtare të NATO-s, me vetëm Rusinë që bën përjashtim. Me Rusinë si përjashtim më të dukshëm. Dhe ndonëse aktualisht ujërat rreth Grenlandës nuk janë të mbushura me anije ruse dhe kineze, kjo mund të ndryshojë kur akulli i Detit Arktik shkrihet dhe hapen rrugë të reja detare. Misioni Roja e Arktikut vjen pasi NATO ka formuar misione të ngjashme në vitin 2025 që janë ende në zhvillim e sipër në Detin Baltik - si përgjigje ndaj sabotimit të dyshuar rus të kabllove nënujore - dhe në krahun lindor të aleancës, pas inkursioneve me dronë rusë në Poloni në shtator të vitit të kaluar.

EPOKA E RE

Botohet nga “Epoka e re” • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

OSMANI ANULON SHKUARJEN NË MUNIH, KURTI SINJALIZON GATISHMËRINË PËR DISKUTIME PËR PRESIDENTIN

PRISHTINË, 12 SHKURT - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani e ka anuluar pjesëmarrjen e saj në Konferencën e Sigurisë në Muni, ka konfirmuar Bekim Kupina, këshilltar për media i presidentes, në disa përgjigje për “Radion Evropa e Lirë”. Si arsye për anulimin e vizitës janë përmendur angazhimet institucionale dhe prioritetet që lidhen me zhvillime brenda vendit. Konferenca e Sigurisë në Muni i mban punimet këtë vit më 13-15 shkurt në qytetin gjerman. Ajo konsiderohet konferencë me nam, për shkak të pjesëmarrjes së zyrtarëve shtetërorë të niveleve më të larta. Paraprakisht ishte raportuar se përveç Osmanit, në këtë konferencë do të merrnin pjesë

edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe shefi i Agjencisë Kosovare të Inteligjencës, Petrit Ajeti. Në nivel botëror, pjesëmarrjen e ka konfirmuar edhe Sekretari amerikan i Shtetit, Marco Rubio bashkë me një delegacion të nivelit të lartë. Vendimi i marrë nga Osmani vjen një ditë pasi Kosova është bërë me Qeveri të re në krye me Albin Kurtin. Qeveria është zgjedhur më 11 shkurt, në të njëjtën ditë që është konstituuar Kuvendi i Kosovës. Kurti me partinë e tij, Lëvizjen Vetëvendosje, ka fituar mbi 51 për qind të votave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, duke siguruar 57 ulëse në Kuvend. Ndër prioritetet kryesore të Qeverisë në ditët e para është



ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që ka Kosova me BE-në dhe Bankën Botërore. Të gjitha së bashku kapin vlerën e rreth 1 miliard eurove. Kryeministri Kurti ka paralajmëruar në mbledhjen e mbajtur në paraditen e së enjtes se pas votimit të buxhetit

të shtetit dhe ratifikimit të marrëveshjeve ndërkombëtare, atëherë fokusi kthehet te çështja e pozitës së presidentit. “Sa të përfundohen këto [marrëveshjet], jam i gatshëm që nga nesër të fillojmë kontaktet dhe diskutimet me subjektet e tjera politike për çështjen e zgjedhjes së

presidentit”. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, e ka thënë hapur se synon edhe një mandat në krye të shtetit. Ende nuk dihet nëse emri i saj do të propozohet në Kuvend dhe nëse do t'i ketë votat e nevojshme. Një kandidat duhet t'i sigurojë dy të tretat e votave të deputetëve në Kuvendin me 120 karrige, ndërsa kuorumi arrihet me 80 deputetë. Nëse në dy rundet e para një kandidat nuk i siguron 80 vota, atëherë në votimin e tretë mjafton t'i ketë 61. Në një intervistë për “Radion Evropa e Lirë”, në fund të dhjetorit, presidentja Osmani ka thënë se nëse nuk e fiton edhe një mandat, atëherë do t'i kthehet angazhimit politik, pa treguar se me cilën parti.

AMBASADA E SHBA-së DHE BE-ja UROJNË KURTIN PËR QEVERINË E RE, PRESIN BASHKËPUNIM

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ambasada amerikane në Prishtinë ka mirëpritur themelimin e Kuvendit dhe formimin e Qeverisë së Kosovës. “Mezi presim që të bashkëpunojmë me Qeverinë e re për avancimin e prioritetëve të përbashkëta, përfshirë paqen rajonale, stabilitetin dhe prosperitetin e ndërsjellë ekonomik”, u tha në një njoftim të publikuar në rrjetet sociale.

Edhe kryediplomatja e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas e ka uruar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti për formimin e Qeverisë së re të vendit. Përmes një postimi në “X” Kallas ka thënë se është krijuar momentum i ri për t'i avancuar marrëdhëniet mes Bashkimit Evropian dhe Kosovës si dhe dialogun mes Prishtinës dhe Beogradit, prandaj vetë ajo është e gatshme të organizojë së shpejti një takim të nivelit të lartë.



Mes tjerash, Kallas e ka përmendur edhe rëndësinë e kryerjes së reformave. “Kjo është rruga më e shpejtë për t'ia hapur rrugën mbështetjes së Bashkimit Evropian në vlerë prej qindra miliona eurove dhe të ketë përparim në rrugën drejt BE-së”, ka thënë Kallas.

Kurtin e ka uruar edhe Komisionarja e BE-së për Zgjerim, Marta Kos, e cila gjithashtu e ka përmendur nevojën për reforma dhe përfitime nga Plani i Rritjes i BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. “Mezi pres ta vizitoj Kosovën shpejt”, ka thënë ajo përmes një postimi në “X”. Qeveria e re, në krye me Kurtin, i ka fituar votat e nevojshme më 11 shkurt, pas konstitutimit të Kuvendit të Kosovës. Kurti me partinë e tij, Lëvizjen

Vetëvendosje, ka fituar mbi 51 për qind të votave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 28 dhjetorit, duke siguruar 57 ulëse në Kuvend. Mbledhja e parë e Qeverisë është planifikuar të mbahet në paraditen e së enjtes. Ndër prioritetet kryesore të Qeverisë në ditët e para është ratifikimi i marrëveshjeve ndërkombëtare që ka Kosova me BE-në dhe Bankën Botërore. Të gjitha së bashku kapin vlerën e rreth 1 miliard eurove.

KDI-ja: NGA LEGJISLATURA E DHJETË PRESIM PROCES LEGJISLATIV MË CILËSOR DHE MBIKËQYRJE EFEKTIVE

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 12 SHKURT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka përgëzuar Kuvendin e Kosovës dhe deputetët e legjislaturës së dhjetë për përmbylljen e seancës konstituive dhe zgjedhjen e kryetares së Kuvendit, Albulena Haxhiu, si dhe pesë nënkryetarëve, pas një periudhe të zgjatur të krizës institucionale. Në komunikatën për medie, KDI-ja vlerëson se funksionalizimi i plotë i institucionit më të lartë përfaqësues përbën një hap të rëndësishëm drejt stabilitetit demokratik dhe rikthimit të

normalitetit institucional. “Funksionalizimi i plotë i institucionit më të lartë përfaqësues përbën një hap të rëndësishëm drejt stabilitetit demokratik dhe rikthimit të normalitetit institucional”, thuhet në komunikatë. KDI-ja vlerëson se Kuvendi mbetet shtylla qendrore e përfaqësimit qytetar, ligjvënies dhe mbikëqyrjes demokratike, duke shtuar se në këtë legjislaturë të re duhet të forcohet roli kushtetues i Kuvendit, të rritet cilësia e procesit legjislativ dhe të sigurohet transparencë më e

madhe në vendimmarrje”, thekson KDI. Tutje, kjo organizatë kërkon rikthimin dhe fuqizimin e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit, si dhe përfshirjen reale të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në procesin legjislativ. “Veçanërisht, presim rikthimin dhe fuqizimin e funksionit mbikëqyrës të Kuvendit, përfshirjen reale të qytetarëve dhe të shoqërisë civile në procesin legjislativ, si dhe trajtimin me prioritet të reformave të mbetura pezull gjatë periudhës së krizës”, thuhet më tej. KDI-ja thekson se rikthimi i besimit qytetar në institucionet



përfaqësuese kërkon përgjegjësi, integritet dhe dialog politik, duke paralajmëruar se do të vazhdojë të monitorojë punën e Kuvendit. “Rikthimi i besimit qytetar në institucionet përfaqësuese kërkon përgjegjësi,

integritet dhe dialog politik. KDI do të vazhdojë të monitorojë dhe të kontribuojë në forcimin e standardeve demokratike dhe të funksionimit parlamentar”, thuhet tutje në komunikatën e KDI-së.



MBROJTJA E KADRI VESELIT DHE REXHEP SELIMIT PARAQESIN DEKLARATAT PËRMBYLLËSE NË PROCESIN GJYQËSOR NË HAGË

MBROJTJA E VESELIT DHE SELIMIT SHKËRMOQIN PRETENDIMET E ZPS-së

-Avokati Dixon: Kadri Veseli duhet të lirohet dhe të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat
-Avokati Roberts: Rexhep Selimi është tërësisht i pafajshëm. ZPS-ja s'ka arritur t'i provojë akuzat

Mbrojtja e ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe ajo e ish-deputetit Rexhep Selimi, kanë paraqitur deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë ndaj liderëve të UÇK-së. Avokati Rodney Dixon, ka thënë se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë të vërtetuar kundër Veselit. Duke adresuar një mori kritikash kundër ZPS-së, Dixon ka thënë se disa dëshmitarë kanë gënjyer nën betim. Ai ka akuzuar ZPS-në se ka ofruar dëshmi të paverifikuara. Në këtë kontekst, ai ka kërkuar nga trupi gjyqësor që të ketë kujdes nga dëshmitë që ZPS-ja ka marrë nga Serbia. Edhe avokati i Selimit, Geoffrey Roberts, ka thënë se klienti i tij është tërësisht i pafajshëm. Roberts i ka thënë trupit gjyqësor se ZPS-ja nuk ka arritur të provojë asnjë prej akuzave të saj

EPOKA E Lirim GECI

HAGË, 12 SHKURT - Pas ekipit mbrojtës të ish-presidentit Hashim Thaçi, deklaratat përmbyllëse në procesin gjyqësor në Hagë i kanë paraqitur mbrojtja e Kadri Veselit dhe e Rexhep Selimit. Edhe mbrojtja e Veselit dhe Selimi kanë shkërmur pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar (ZPS) kundër liderëve të UÇK-së. Avokati kryesor i Veselit, Rodney Dixon, ka thënë se çështja kundër klientit të tij është “si përpjekje për të gjetur një rrëshinë”. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ZPS-ja nuk ka paraqitur asnjë provë inkriminuese kundër Veselit. “Çështja e prokurorisë kundër Veselit mund të përshkruhet si një përpjekje për të gjetur një rrëshinë. Për më shumë se pesë vjet që kur u ngrit aktakuza, e madje edhe më parë, që në 2015 ku u krijuan Dhomat e Specializuara dhe filluan hetimet, ZPS-ja ka gjurmuar diçka që nuk ekziston, janë munduar që të gjejnë prova për përfshirjen e Kadri Veselit në veprimtari penale”, ka thënë Dixon. Sipas tij, rasti ndaj Veselit është unik “sepse nuk ka asnjë provë e jo më të këtë bërë ndonjë vepër penale”. Dixon ka thënë se rasti ndaj liderëve të UÇK-së zgjat për më shumë se pesë vjet, por është shprehur i bindur se Veseli do të lirohet i pafajshëm. “Koha që ka kaluar, sado që të ketë qenë e rëndë dhe e vështirë, do të ishte me vlerë

dhe e gjithë ajo bojë që është harxhuar në mijëra faqe të dosjeve tona, fondet që janë shpenzuar për këtë gjykatë do të jenë më vlerë për viktimat dhe të gjithë. Do të jenë më vlerë për Kosovën dhe tërë popullin e saj, pavarësisht përkatësisë etnike. Kjo do të bëjë që përfundimi i gjykimit të Veselit për një kohë për më shumë se 5 vitesh do të jetë sukses, jo vetëm për shkak se do të lirohet një person i pafajshëm, por do të vendoset edhe precedenti që brezat e ardhshëm do të zbatojnë”, ka thënë avokati Dixon, duke shtuar se Veseli duhet të lirohet nga Haga. “Veseli meriton një vendim të drejtë dhe të duhur. Ai duhet të lirohet dhe të shpallet i pafajshëm për të gjitha akuzat. Nëse ndodh e kundërta, do të ishte një padrejtësi e madhe”, ka thënë Dixon.

ZPS-ja me prova të pavërtetuara kundër Veselit

Duke kritikuar ZPS-në, avokati Dixon ka thënë se janë dy raste kur prokuroria ka ofruar dëshmi kundër Veselit, por të cilat sipas tij janë dëshmi të pavërtetuara. Sipas tij, ZPS-ja synon të përdorë një provë, të pavërtetuar, të një personi që nuk është paraqitur në gjykatë, dhe ta përdorë si bazë për fajësinë e Veselit, duke shtuar se këto nuk janë në formën e deklaratës të një dëshmitari. “ZPS-ja mbështetet në prova dytësore. Por, pala mbrojtëse nuk ka

mundur t'i marrë në pyetje këta dëshmitarë ku bazohen këto informacione”, ka thënë ai. Pretendimi i dytë, ka thënë Dixon, ka të bëjë për një të ndaluar në Kleçkë. Ai ka thënë se edhe ky pretendim i ZPS-së është e bazuar në një informacion të dorës së dytë. “Akuza e vetme që vjen për pjesëmarrjen e tij të drejtpërdrejt vjen nga një dëshmitar të cilin unë nuk mund ta marr në pyetje”, ka thënë Dixon. Avokati Dixon, i ka thënë trupit gjyqësor se shumë dëshmitarë të ZPS-së kanë dhënë dëshmi të rreme dhe atë nën betim. “Dëshmitarët e thirrur nga ZPS-ja janë thirrur për pohimin e vërtetësisë të qëndrimit të saj. Por, në të njëjtën kohë ne kemi parë që ZPS-ja ka sulmuar dëshmitarë dhe kemi pasur persona të vërtetë prej të cilëve ZPS-ja nuk ka marrë përgjigje, derisa gënjeshtarëve u ka dhënë mundësi për t'i dhënë përgjigjet e tyre. Kështu që, si është e mundur që gjykata të mbështetet në pjesë të caktuara të dëshmitarëve për të dhënë vendim fajësie përtej dyshimit të arsyeshëm, ndërkohë që për të tjerët thuhet se nuk mund të besohen për asnjë aspekt? Ka pasur persona që kanë gënjyer nën betim, duke mos e thënë të vërtetën”, ka deklaruar Dixon, duke shtuar se pretendimet e ZPS-së janë “përpjekje të kota”. Në këtë drejtim, Dixon i ka bërë thirrje trupit gjyqësor që t'i ndajë faktin nga shpikjet. “Aktgjykimi juaj do të ketë vend në histori dhe nuk

do të harrohet. Pavarësisht sa është përpjekur Prokuroria t'ju bindë që ta shpallni fajtor zotin Veseli, ne e kundërshtojmë këtë me parimin ligjor dhe shtetin ligjor, që është në qendër të të gjitha gjykatave ndërkombëtare. Kur nuk ka prova, apo kur provat janë të dobëta, nuk mund të ketë shpallje fajësie”, ka thënë avokati i Veselit.

Pretendimet kundër Veselit në nivel të thashethemeve

Mbrojtësi i Veselit ka insistuar se ndaj klientit të tij nuk ka asnjë provë për përfshirje në krime, por ka thënë se “kemi ngulur në duart e thashethemeve”. Ai ka theksuar se emri i Veselit përmendet 260 herë në dosjen e ZPS-së, por në asnjë rast emri i tij nuk i përmendet në një kontekst që ka element kriminal. “Pretendimet e drejtpërdrejta (për përfshirje në krime të Veselit) janë bazuar tërësisht në prova dytësore, shpesh dhe janë hequr. ZPS-ja nuk ka gjetur asnjë dëshmitar që të vijë në gjykatë dhe të thotë se Veseli ka kryer krime. S'mund ta bënin sepse nuk ekziston”, ka thënë avokati Dixon. Avokati Dixon ka thënë në periodhën e luftës askush nuk e njihje Veselin, por kur ai është bërë i njohur pas luftës, në aspektin politik, kanë dalë disa persona që janë përpjekur ta njollosnin emrin e tij. “Ndonëse nuk thanë asgjë kundër tij në luftë, pas luftës dolën me akuza të pabaza. Por, asnjë prej tyre nuk erdhi këtu në mënyrë që ta kontestonim”, ka thënë Dixon.

Veseli ishte anëtar i përkushtuar i UÇK-së

Më tutje, avokati Dixon, ka thënë se Kadri Veseli ka qenë student kur i ishte bashkuar UÇK-së dhe ishte anëtar i përkushtuar i saj. Dixon ka thënë se Veseli ka luftuar për çlirimin e Kosovës nga regjimi i Serbisë “Ai luftoi për lirinë e Kosovës dhe për të pasur një të ardhme pa ndarje dhe pa

brutalitet. Por, ky nuk është krim”, ka thënë Dixon. Sipas tij, ZPS nuk ka asnjë provë kundër Veselit dhe asnjë dëshmitar nuk e ka përmendur atë, madje nuk e kanë njohur Veselin. “Provat tregojnë se ai ka punuar në UÇK që të parandalonte civilët e Kosovës të ndëshkoheshin, të shënjestroheshin. Këtë e ka bërë me komunitetin diplomatik, në fushën e zbulimit”, ka thënë ai, duke argumentuar se për periudha të gjata, që mbulohen në aktakuzë, Veseli nuk gjendej në Kosovë. “ZPS-ja mund të argumentojë deri sa të vjen fundi i botës nëse dëshiron se kanë prova kundër Veselit, por kjo nuk ndryshon që ju të nderuar gjykatës mund ta shihni tani që në fakt është një çështje e dobët kundër tij. Madje, është pikërisht mosekzistenca e provave. ZPS-ja ndjek të kotën”, ka thënë Dixon.

“ZPS-ja nuk ka prova që Veseli drejtoi ShIK-un gjatë luftës”

Rodney Dixon, avokati i Kadri Veselit ka hedhur poshtë pretendimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për funksionimin e Shërbimit Informativ të Kosovës (ShIK) në kohën e luftës dhe drejtimin e tij nga Veseli. “Asnjë provë nuk na ka sjell ZPS-ja se ShIK-u ka qenë funksional në atë kohë. Vetëm pas luftës u krijua struktura e Shërbimit Informativ të Kosovës dhe vetëm në atë kohë ishte në gjendje të drejtonte atë”, ka thënë ai. Dixon ka thënë se provat tregojnë se gjatë luftës ishte e pamundur të krijohej një strukturë e tillë. “Kur Veseli flet për zhvillimin e Shërbimit Informativ i Kosovës (ShIK) pas luftës, ajo s'ka të bëjë fare me atë që mund të ketë ndodhur gjatë luftës. Nëse pas luftës po konsiderohej marrja e ndonjë informacioni, kjo nuk do të thotë se diçka e tillë ka ndodhur edhe gjatë luftës”, ka thënë Dixon.

“Gjykata Speciale duhet të ketë kujdes nga dëshmitë që ua dha Serbia”

Avokati i Kadri Veselit, Rodney Dixon, ka kërkuar nga Gjykata Speciale që të ketë kujdes nga dëshmitë e dhëna nga Serbia. Përveç kësaj, ai ka thënë se mbështetja e autoriteteve ndaj kësaj gjykate duhet të merret parasysh. “Autoritetet serbe dhe mbështetja e tyre për këtë gjkatë po ashtu duhet të merren parasysh, në veçanti kur flitet për qëllime forenzike dhe për vlerësimin e provave që ata i kanë dhënë gjykatës”, ka thënë Dixon gjatë paraqitjes së deklaratës përfundimtare në rastin e liderëve të UÇK-së.

Avokati Dixon ka thënë se nuk është e ndershme në aspektin intelektual që të argumentosh dhe ta anashkalosh politikat serbe. “Sikurse e kam theksuar edhe më herët, në aspektin intelektual nuk është e ndershme që të argumentosh që mund të anashkalosh politikat serbe dhe dominim serb, ndërkohë që vlerësohet nëse UÇK-ja ka pasur në thelb të njëjtën politikë dhe në të njëjtën kohë të thuash se ka shkuar në drejtim tjetër”, ka thënë ai.

Avokati i Veselit ka thënë se Serbia ka kryer aparteid në Kosovë, ngjashëm si në Afrikën e Jugut. Por, dallimi sipas Dixonit është që Serbia është munduar të gjykojë ata që kishin vuajtur nën sistemin e tyre, ndërsa në Afrikën e Jugut, ekzekutorët kishin pranuar fajin. Përpara kësaj, Dixon ka thënë se Dhomat e Specializuara të Kosovës (DhSK) në Hagë janë të rëndësishme për Kosovën në aspekt të sundimit të ligjit. “Rëndësia e DhSK-së për Kosovën është absolutisht e rëndësishme për sundimin e ligjit dhe për pajtme të ardhshme, edhe për një vend të tillë të botës që nuk është në qendër të vëmendjes së botës apo që nuk tërheq vëmendje kryesore në titujt e gazetave ose të lajmeve kryesore, përsëri është e rëndësishme që të merret parasysh e gjithë mbështetja e vendit për këtë gjykatë”, ka thënë Dixon.

Në deklaratën e tij përmbyllëse, avokati Rodney Dixon, ka thënë se nuk mund të injorohet ajo se çfarë ka bërë Serbia në Kosovë dhe se ata nuk kanë qenë thjesht “dele që kalonin gjatë natës”. Ai ka thënë se në Kosovë ka pasur aparteid ngjashëm qysh si ndodhur në Afrikën e Jugut. Por, për dallim të fundit kishin kërkuar falje ndaj viktimave, ndërsa Serbia ka akuzuar persona që

kanë vuajtur nën sistemin e tyre. “Ata (në Afrikën e Jugut) kërkuan ndjesë për atë se çfarë kishin bërë. Në Kosovë, arkitektët serbë dhe ekzekutuesit e bënë të kundërtën. Ata akuzuan persona që kanë vuajtur në atë sistem dhe kërkuan që ata që kanë vuajtur të gjykoheshin dhe në fakt jo vetëm kaq, por dhanë prova që kjo të bëhej për t’iu thënë ndërkombëtarëve që ‘ju kemi thënë se këta të UÇK-së janë rrugaçë e janë të pabindur. Ne kemi pasur të drejtë për atë se çfarë kemi bërë në Kosovë’”, ka thënë Dixon, duke shtuar se angazhimi i Kosovës ndaj drejtësisë duhet të përgëzohet.

MBROJTJA: REXHEP SELIMI ËSHTË TËRËSISHT I PAFAJSHËM. ZPS-ja NUK KA ARRITUR T’I PROVOJË AKUZAT

Pas mbrojtjes së Kadri Veselit, deklaratën përfundimtare në procesin gjyqësor e ka paraqitur avokati kryesor i Rexhep Selimit, Geoffrey Roberts. Ai në fillim të deklaratës së tij ka thënë se ZPS-ja nuk ka arritur të vërtetojë asnjë nga krimet që i ngarkohen klientit të tij. “Selimi është tërësisht i pafajshëm për të gjitha krimet në aktakuzë. ZPS-ja thjesht nuk ka arritur të provojë asnjë prej këtyre krimeve të pretenduara. Kaq është dhe ky është qëndrimi ynë”, ka thënë ai.

Më tutje, Roberts, ka thënë se qëndrimi i mbrojtjes është se nuk ka ekzistuar “Ndërmarrja e Përbashkët Kriminale (NPK)”, ku ka qenë i përfshirë Selimi apo të akuzuarit e tjerë në asnjë periudhë të aktakuzës, siç pretendon prokuroria. “Në mungesë të NPK-së nuk mund të ketë përgjegjësi për Selimin për kryerjen e krimeve”, ka thënë ai.

Sipas tij, pretendimi i ZPS-së për një ndërmarrje të tillë “është i mangët në logjikë dhe i mangët në prova dhe kjo shihet në çdo aspekt”, ka thënë Roberts.

Avokati i Selimit ka thënë se pretendimi kryesor i prokurorisë është se të akuzuarit së bashku me anëtarët e tjerë të asaj që e cilëson si “ndërmarrje të përbashkët kriminale” kishin për qëllim marrjen nën kontroll të Kosovës dhe largimin e kundërshtarëve.

Roberts ka thënë se qëllimi i UÇK-së ka qenë dhënia fund shtypjes nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit. “Në vetvete qëllimi për marrjen nën kontroll Kosovën nuk është kriminal, por mënyrë

për t’i dhënë fund shtypjes së Millosheviqit. Duhet të konstatoji se ka pasur një pajtim për krimet e pretenduara. Çështja e objektivit jokriminal, teoria e prokurorisë është se ky ishte qëllimi kryesor i të akuzuarve dhe jo çlirimi i popullit të tyre, por vetëm synim për të marrë pushtet në mënyrë egoiste”, ka thënë Roberts.

Avokati i Selimit kundërshton se komunikatat e UÇK ishin udhëzime për kryerjen e krimeve

Avokati i Rexhep Selimit, Geoffrey Roberts, ka kundërshtuar pretendimet e ZPS-së se komunikatat e UÇK-së kishin dy funksione: “ishin si udhëzime që u jepeshin komandantëve të zonave që të shënjestronin bashkëpunëtorët, por shërbenin edhe si paralajmërim për kundërshtarët e mundshëm dhe ata aktualë”. Ai ka thënë se Selimi j nuk ka marrë pjesë në përgatitjen e këtyre komunikatave.

Avokati Roberts ka përmendur një rast nga dosja e prokurorisë, ku Selimi kishte kërkuar lirimin e një të ndaluar, që ishte marrë në pyetje nga UÇK-ja, nën dyshimet se ishte bashkëpunëtor i Serbisë. Roberts po ashtu ka thënë se disa ndalime nga komandantët e zonave u kryen pa dijeninë e shtabit të përgjithshëm dhe ato u fshehën nga shtabi, duke argumentuar se “kjo mungesë logjike” e pretendimit të ZPS-së se komunikatat ishin udhëzime “është befasuese”.

“S’është e habitshme që të ketë gabime në deklaratat e Selimit”

Avokati Geoffrey Roberts, ka thënë se nuk është e habitshme që ka pasur gabime në deklaratat e Rexhep Selimit, në të cilat ka materiale kundër tij dhe bashkë të akuzuarve të tjerë. Ai këtë deklaratë e ka thënë për faktin se prokuroria mbështetet në intervistën e Selimit që ia ka dhënë asaj dhe intervista të tjera që i ka dhënë për gjykatat e tjera e në medie. “Sipas vlerësimit të mbrojtjes, intervista e Selimit e dhënë ZPS-së përmendet 236 herë në dosjen përfundimtare. Në të shumtën e rasteve kjo intervistë është burimi i vetëm më të cilin mbështetet prokuroria...”, ka thënë ai, duke shtuar se kësaj deklaratë nuk

mund t’i jepet peshë e konsiderueshme pa pasur konfirmim dhe pa vërtetuar pretendimet përtej dyshimit të arsyeshëm. “Siç e ka thënë trupi gjykues në mënyrë të qartë, këtyre deklaratave, intervistave dhe transkripteve të zotit Selimit nuk mund t’iu jepte një peshë e konsiderueshme pa pasur konfirmimin për të përcaktuar apo vërtetuar pretendimin përtej dyshimit të arsyeshëm”, ka thënë Roberts.

Roberts ka thënë se ky është një vlerësim kyç dhe i rëndësishëm për trupin gjykues në momentin kur bëhet vlerësimi i provave që janë para tyre. Përveç kësaj, Roberts ka thënë se Selimi ka përdorur të drejtën e tij për të mos dhënë dëshmi dhe se intervistat e mëhershme rrjedhimisht nuk i ka korrigjuar dhe as qartësuar. “Mbrojtja nuk thirrri dëshmitarë dhe Selimi përdori të drejtën për të mos dhënë dëshmi. Për rrjedhojë, në këtë Gjykatë asnjë prej fjalëve që mendohet se janë thënë nga zoti Selimi në intervista të tij të dhëna për ZPS-në apo intervistat e tjera, nuk janë të verifikuara apo kontestualizuara apo verifikuara nga ai. Ato nuk i ka korrigjuar, qartësuar, apo ndryshuar këto intervista mbi të cilat mbështetet prokuroria përkundër shumë dëshmitarëve të prokurorisë të cilët kanë verifikuar me kujdes deklaratat e tyre të mëparshme e shpesh me ndihmën e avokatit dhe të cilat kanë bërë korrigjime të gjera në deklaratat e tyre”, ka thënë ai.

Roberts ka thënë se Selimi s’ka bërë betim para Gjykatës Speciale për të folur për saktësinë e dëshmisë së tij të dhënë për prokurorinë.

Rrjedhimisht, Roberts ka thënë se nuk është e habitshme që të ketë gabime në deklaratat e mëhershme të Selimit. “Nuk është e habitshme që të ketë gabime në këto deklarata”, ka thënë Roberts.

Në deklaratën përmbyllëse, avokati Roberts ka thënë se prokuroria nuk ka argumentuar se si e mbështet pretendimin se Selimi ishte inspektor i përgjithshëm i UÇK-së deri në korrik të vitit 1998. Ai ka thënë se nuk ka prova për kohën kur Selimi është emëruar dhe nuk ofron asnjë dëshmitar për këtë çështje.

Lidhur me rolin e Selimit si inspektor, ZPS-ja, ka thënë Roberts, e ka vendosur atë në nivel të komandantit të përgjithshëm dhe ishte mbi drejtoritë.

Ai ka argumentuar se Selimi nga ky post nuk kishte autoritet të

shqiptonte masa disiplinore dhe as nuk është thënë nga prokuroria se inspektorati ka pasur strukturë. Roberts ka thënë se dëshmitë e vendosin Selimin si ndihmues apo asistent për komandantin e përgjithshëm nga posti i inspektorit.

Mbrojtja e Selimit flet për Adem Jasharin

Avokati Geoffrey Roberts, ka thënë se si anëtarë të dyshuar të NPK-së përmenden shumë emra, që nuk janë të akuzuarit, dhe prokuroria synon të bëjë lidhjen e tyre me të akuzuarit duke pretenduar qëllimin e përbashkët kriminal. Ai ka thënë se në këtë proces nga prokuroria është përmendur edhe Adem Jashari, duke kujtuar se ai është përmendur kur ka luftuar në fillim të viti 1998 në Prekaz, por Roberts ka shtuar se nuk përmendet fare “masakra që i ka ndodhur kësaj familjeje”.

“Përmendet edhe në raste të tjera që është takuar me Veselin dhe Thaçin më 1992, apo që është prezantuar me Selimin nga Sylejman Selimi më 1994. Po ashtu, thuhet se më 4 mars 1998 është takuar me Selimin, Sabit Gecin, Rrahman Ramën dhe të tjerët për të diskutuar për armët dhe UÇK-në. Përfundimi i logjikshëm që ka nxjerrë ZPS-ja që këto lidhje mes të akuzuarve dhe Adem Jasharit janë relevante për argumente të ZPS-së apo NPK-së”, ka thënë Roberts.

Ai ka thënë se mendon që prokuroria e ka bërë këtë sepse sipas tyre “edhe Adem Jashari është anëtar i pretenduar i NPK të cilit nuk ia përmendin emrin. Pra, nuk mund të diskutosh thelbin e NPK dhe të pretendosh që çdo anëtar i lartë i UÇK-së ka qenë pjesë e kësaj ndërmarrjeje, përfshirë këtu edhe Adem Jasharin”. “Megjithatë, unë mendoj që nëse e pyet prokurorinë ajo s’mund të përgjigjet. Nëse e pyesni a ka qenë Adem Jashari pjesë e kësaj NPK-së që pretendoni ju sepse po të ishte kështu prokuroria do të ishte në gjendje ta vërtetojë këtë”, ka thënë avokati i Selimit.

Mbrojtja e Selimit do të vazhdojë edhe sot (e premtë) me paraqitjen e deklaratës përmbyllëse. Po ashtu, sot pritet që deklaratën përmbyllëse ta paraqesë edhe avokatja e Jakup Krasniqit, Venkateswari Alagendra. Pas përfundimit të deklaratave përmbyllëse nga avokatët, të drejtën e fjalës do ta kenë Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi.



RUTTE THOTË SE ENDE PO PRET QË SERBIA TË PËRCAKTOJË PËRGJEGJËSINË PËR BANJSKËN

PRISHTINË, 12 SHKURT - Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, ia ka kujtuar presidentit të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, se aleanca ende po pret përcaktimin e përgjegjësisë për ngjarjet që kanë ndodhur në Kosovë gjatë vitit 2023. “Unë personalisht, por edhe si përfaqësues i NATO-s, jam në kontakt të ngushtë me presidentin serb. Ende po presim nga ai përcaktimin e përgjegjësisë për atë që ndodhi në vitin 2023 në Banjskë dhe për ngjarje të tjera gjatë vitit 2023”, tha Rutte.

Kërkesë të ngjashme për përcaktimin e përgjegjësisë për Banjskën, sekretari Rutte bëri në fund të janarit.

Ai shtoi se NATO-ja, përmes misionit të saj paqeruajtës në Kosovë, KFOR, i ndjek me kujdes të gjitha zhvillimet në Kosovë.

Në shtator të vitit 2023, një grup i serbëve të armatosur sulmuan Policinë e Kosovës në Banjskë të Zveçanit duke vrarë një polic. Gjatë këmbimit të zjarrit u vranë edhe tre sulmues serb. Politikani nga Kosova dhe

biznesmeni Millan Radoiçiq e mori përgjegjësinë për sulmin, dhe prej atëherë ai ndodhet në Serbi, ku nuk është ndjekur penalisht deri më sot.

Kosova kërkon ekstradimin e tij, pasi Prokuroria Speciale veçse ka ngritur një aktakuzë për këtë rast dhe Radoiçiq është pjesë e aktakuzës.

Ndërkaq, sa i përket situatës në Bosnjë e Hercegovinë, ai ka përsëritur se nuk do të lejojë krijimin e një vakumi të sigurisë në këtë shtet.

Rutte këto deklarata i bëri në prag të takimit të paraparë të ministrave të mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s, i cili do të mbahet të enjten, më 12 shkurt. Ministrat do të diskutojnë për mbështetjen ushtarake për Ukrainën, që po përballlet me luftën e nisur nga Rusia pothuajse pesë vjet më parë. “[Presidenti rus, Vladimir] Putini po përpiqet ta thyjë popullin e Ukrainës, duke shpresuar se do ta dobësojë vendosmërinë e tyre. Por, populli ukrainas ka treguar shumë herë se nuk do të thyhet”, ka theksuar Rutte.



Ndryshe, ky do të jetë takimi i dytë i ministrave në të cilin nuk marrin pjesë sekretarë nga Shtetet e Bashkuara.

Sekretari amerikan i Mbrojtjes, Pete Hegseth, në Bruksel ka dërguar zëvendësin e tij, Elbridge Colby. Në dhjetor të vitit të kaluar, në takimin e ministrave të Punëve të Jashtme të aleancës, po ashtu mungoi

sekretari i shtetit Marko Rubio. Sekretari Rutte, tha se nuk e sheh këtë si shenjë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk janë më të përkushtuara ndaj aleatëve. “Nuk besoj aspak në këtë. Duhet të them se bisedat dhe kontaktet e mia me udhëheqjen e lartë amerikane, qoftë me Shtëpinë e Bardhë, Pentagonin apo Departamentin

e Shtetit, janë po aq intensive sa gjithmonë. Këta njerëz veprojnë në mbarë botën. Natyrisht që NATO-ja është e rëndësishme, por ata gjithashtu duhet të veprojnë në hemisferën perëndimore dhe në Paqësor, prandaj e kuptoj plotësisht që ministrat më të lartë nuk mund të jenë gjithmonë këtu”, tha ai.

PËRFAQËSUESIT SERBË NË KOSOVË KËRKOJNË QË PËR ÇËSHTJET E ARSIMIT DHE SHËNDETËSISË TË DISKUTOHET NË BRUKSEL

MITROVICË, 12 SHKURT - Përfaqësuesit e komunave me shumicë serbe në Kosovë kanë miratuar një deklaratë përmes së cilës u tha se refuzohet dhe dënohet çdo veprim apo ndërhyrje që mund të rrezikojë punën dhe ofrimin e shërbimeve të institucioneve shëndetësore dhe arsimore.

Këto çështje ata kërkuar që të zgjidhen përmes dialogut për normalizimin e raporteve, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian.

Në Mitrovicë të Veriut më 12 shkurt, me ftesë të Listës Serbe u mbajt një seancë e përbashkët e komunave me shumicë serbe, ku morën pjesë edhe përfaqësues të institucioneve shëndetësore dhe arsimore në mjediset e banuara me serb në Kosovë, që funksionojnë sipas sistemit të Serbisë. “Në vlerësimin tonë, të gjitha çështjet e hapura, përfshirë edhe statusin e këtyre institucioneve, duhet të zgjidhen ekskluzivisht përmes dialogut ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës për themelimin e Asociacionit të komunave me shumicë serbe, dhe ne kundërshtojmë në mënyrë absolute veprimet e dhunshme, të njëanshme, si dhe çdo veprim tjetër që do të rrezikonte funksionimin e



këtyre dy sektorëve”, thuhet në deklaratën e miratuar në këtë takim.

Po ashtu, përmes deklaratës përshëndeten përpjekjet e vendeve të QUINT-it për gjetjen e një “zgjidhjeje të qëndrueshme dhe të bazuar në parime të drejtësisë”.

Në deklaratë thuhet po ashtu se “veprimet e njëanshme kundër institucioneve arsimore dhe shëndetësore, që merren jashtë dialogut në Bruksel dhe Asociacionit të komunave me shumicë serbe”, si dhe zbatimi i Ligjit për të huajt dhe Ligjit për automjetet, “përbëjnë spastrim

etnik administrativ të popullit serb”.

Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit, tha më herët se në këtë takim do të diskutohej për situatën politike dhe të sigurisë pas njoftimit për zbatimin e plotë të ligjeve për të huajt dhe për automjetet.

Simiq thotë Ligji për të huajt “rrezikon studentët dhe të punësuarit” serbë

Në fillim të takimit, zyrtari i Listës Serbe dhe deputeti në

Kuvendin e Kosovës, Igor Simiq, tha se Ligji për të huajt do të rrezikojë studentët, të punësuarit në institucionet e Serbisë, biznesmenët, serbët e zhvendosur që kanë pronë në Kosovë, si dhe klerin e Kishës Ortodokse Serbe, duke shtuar se për të gjitha këto është njoftuar edhe bashkësia ndërkombëtare. “Janë vënë në rrezik themelet e ekzistencës sonë dhe ne duhet të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë për ta mbrojtur popullin tonë. Në këtë situatë ku ndodhemi na ka sjellë regjimi në Prishtinë me veprime të

njëanshme gjatë viteve të fundit, me qëllim që populli serb të mos mund të mbijetojë”, u shpreh ai.

Simiq theksoi se Lista Serbe nuk ka marrë pjesë në asnjë negociatë, ashtu siç po e akuzojnë disa subjekte të tjera politike.

Takimi më pas u zhvillua prapa dyerve të mbyllur.

Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal në Qeverinë e Kosovës, Elbert Krasniqi, i ka ftuar kryetarët e komunave me shumicë serbe në një takim të premtën, me qëllim që të bisedohet për integrimin e institucioneve serbe të shëndetësisë dhe arsimit.

Dhjetë komunat me shumicë serbe në Kosovë - Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zveçani, Zubin Potoku, Graçanica, Shtërpca, Klllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Novobërda - udhëhiqen nga kryetarë të Listës Serbe, dhe për momentin nuk dihet nëse ata do t'i përgjigjen kësaj ftese. Njoftimi për fillimin e integritit të institucioneve arsimore dhe shëndetësore përkon me nisjen e zbatimit të fazës së parë të aplikimit të plotë të Ligjit për të huajt, që cila do të zgjasë deri më 15 mars dhe parasheh një periudhë informimi.

Gucati i shkon në zyre Ramës, ia uron mandatin e dytë

PRISHTINË, 12 SHKURT - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka pritur në takim kryetarin e OVLUÇK-së, Hysni Gucati, i cili i ka uruar mandatin e dytë

Ramës. Kryetari i Prishtinës ka thënë se Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së përfaqëson një kapitull të lavdishëm të

historisë sonë dhe mbart me vete peshën e sakrificës për liri. “Vlerësoj këtë mbështetje dhe besim, duke riafirmuar se Kryeqyteti do të qëndrojë

gjithmonë pranë veteranëve, me respekt dhe mirënjohje të thellë për kontributin e tyre”, ka shkruar Rama në “Facebook”.



INSTITUTI GAP REKOMANDON KRIJIMIN E POZITAVE TË DEDIKUARA PËR ZYRTARË TË DIASPORËS NË KOMUNA

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 SHKURT - Instituti GAP, me mbështetjen e GIZ-it në emër të Qeverisë Gjermane, ka organizuar tryezën e diskutimit ku u prezantua raporti “Fuqizimi i kapaciteteve të komunave për angazhimin e diasporës në Kosovë”. Raporti paraqet një vlerësim të plotë të shërbimeve që lidhen me diasporën në nivel komunal në Kosovë, me synimin për të identifikuar ndërhyrje praktike që mund të përmirësojnë angazhimin lokal, ofrimin e shërbimeve dhe koordinimin me komunitetet e diasporës. Në raport evidentohet mungesa e një kornize ligjore që do të siguronte mbështetje të qëndrueshme, gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar për angazhimin e diasporës në nivel komunal. Brenda këtij kuadri ligjor të paqartë, komunat kanë miratuar një sërë organizimesh institucionale. Disa kanë krijuar struktura formale, si drejtori për diasporën, sektorë ose zyra të dedikuara, ndërsa të tjerat kanë ngritur njësi më të vogla ose nuk kanë fare infrastrukturë që lidhet me diasporën. Për më tepër, komunat shpesh nuk kanë burimet dhe qartësinë ligjore të nevojshme për të krijuar pozita të reja që lidhen me diasporën ose për të integruar çështjet e diasporës në planifikimin afatgjatë. Andaj, zyrtarët për diasporë në disa komuna janë të shpërndarë në drejtoritë për kulturë, ekonomi, administratë apo turizëm dhe, në shumicën e rasteve, kanë edhe përgjegjësi



të tjera administrative ose operative, çka e bën angazhimin ndaj diasporës sezonal dhe kryesisht formal. Shërbimet administrative mbeten forma më e zakonshme e angazhimit të diasporës me nivelin lokal, të fokusuara kryesisht në dokumentacionin civil dhe regjistrimin e pronës. Disa komuna kanë ndërmarrë hapa për të përmirësuar cilësinë dhe qasjen në këto shërbime, veçanërisht gjatë periudhave të vizitave të mëdha të diasporës, por angazhimi më i gjerë ekonomik dhe kulturor mbetet i kufizuar. Ndonëse dallohet rritjet e interesimit të komuniteteve të diasporës për të investuar në Kosovë, veçanërisht në sektorë si ndërtimtaria, bujqësia,

gastronomia dhe prodhimi, shumë prej komunave ende nuk kanë sisteme për të ndjekur në mënyrë efektive këto kërkesa apo regjistruar të njëjtat në databaza që përditësohen rregullisht. Në përgjithësi, komunat nuk kanë hapësira të dedikuara për informim dhe komunikim me diasporën në faqet e tyre zyrtare. Po ashtu, gjatë tryezës, Bekim Salihu, analist politikash në GAP, tha se raporti gjen se koordinimi ndërmjet MPJD-së dhe komunave mbetet i ulët dhe jo sistematik, gjë që ka sjellë përsëritje të aktiviteteve, pasiguri në politika dhe qasje të kufizuar në programet kombëtare. Instituti GAP rekomandon krijimin e pozitave të dedikuara

për zyrtarë të diasporës në komuna, me mandate të qarta dhe kapacitete të forcuara profesionale, si dhe institucionalizimin e shërbimeve për diasporën gjatë gjithë vitit, duke i zgjeruar ato përtej detyrave administrative drejt investimeve, turizmit dhe angazhimit ekonomik. Po ashtu, theksohet nevoja për zhvillimin e strategjive afatgjata komunale për angazhimin e diasporës, të harmonizuara me politikat kombëtare dhe të mbështetura nga struktura të përhershme dialogu dhe koordinim i forcuar me MPJD. Raporti thekson rëndësinë e rritjes së dukshmërisë së mundësive për investime përmes platformave digjitale, bazave të përbashkëta të të dhënave dhe paketave për

investitorë, si dhe integrimin e shoqatave të diasporës, partneriteteve ndërkombëtare dhe mekanizmave ndërkomunalë për zhvillim lokal dhe tërheqje të investimeve. Në këtë kontekst, rekomandohet mbështetja e nismave për të rinjtë, gratë dhe kthimin e profesionistëve nga diaspora përmes skemave të granteve dhe qasjeve të ndjeshme ndaj gjinisë, si dhe zhvillimi i një sistemi të unifikuar digjital me platformën e-Diaspora si portë qendrore për shërbime komunale dhe kombëtare. Në tryezën e diskutimit kontribuuan edhe kryetarët e komunave, përfaqësuesit e GIZ, zyrtarë komunal, përfaqësues të institucioneve të nivelit qendror dhe akterë të tjerë.

Gërvalla me zyrtarin gjerman Schwabes: Kosova, partner i besueshëm në drejtësi dhe stabilitet rajonal

PRISHTINË, 12 SHKURT - Ministrija e Drejtësisë, Donika Gërvalla, ka pritur në takim Frank Schwabe, sekretar shteti parlamentar në Ministrinë Federale të Drejtësisë dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të Gjermanisë, deputet i Bundestagut gjerman nga radhët e SPD-së. “Takimi me z. Schwabe ishte i pari, me mua si

ministre e Drejtësisë dhe pati në fokus bashkëpunimin konkret në fushën e drejtësisë. Republika e Kosovës është një demokraci funksionale me orientim të pakthyeshem euroatlantik, e ndërtuar mbi standardet më të larta të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore, me një rend kushtetues që garanton

barazi për të gjitha komunitetet. Anëtarësimi ynë në Këshillin e Evropës është pasqyrim i këtij realiteti institucional”, ka shkruar në “Facebook” Gërvalla. Ajo ka thënë se angazhimi personal i Schwabes ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë drejtpërdrejt në forcimin e bashkëpunimit në

drejtësi dhe në avancimin e stabilitetit në rajon. “E falënderova z. Schwabe për mbështetjen e vazhdueshme që ai dhe Gjermania i kanë dhënë Kosovës, veçanërisht në rrugëtimin drejt anëtarësimit në Këshillin e Evropës, dhe theksova se Kosova do të vazhdojë të veprojë si faktor i



përgjegjshëm, partner i besueshëm dhe shtet që kontribuon në vazhdimësi në sigurinë dhe zhvillimin demokratik të Evropës”, ka theksuar ajo.

Dogana e Kosovës merr pjesë në Forumin Global për Vetëcertifikimin e Origjinës

BRUKSEL, 12 SHKURT - Dogana e Kosovës po merr pjesë në WCO Global Forum on Origin Self-Certification, i organizuar në selinë e Organizatës Botërore të Doganave në Bruksel. Ky forum global mbledh përfaqësues të administratave doganore, organizatave ndërkombëtare dhe komunitetit global të tregtisë për të shqyrtuar zhvillimet më të fundit, sfidat dhe praktikatat më të mira në këtë fushë strategjike. Vetëcertifikimi i origjinës konsiderohet një

instrument modern dhe efikas që rrit konkurrueshmërinë e bizneseve, përshpejton procedurat tregtare dhe siguron zbatim më efektiv të marrëveshjeve të tregtisë së lirë. Pjesëmarrja aktive e Doganës së Kosovës në këtë forum global lartë konfirmon angazhimin e saj për harmonizim të plotë me standardet e OBD-së, zhvillim të kapaciteteve profesionale dhe avancim të mëtejshëm të reformave modernizuese. Shkëmbimi i përvojave dhe ekspertizës me partnerë

ndërkombëtarë kontribuon në forcimin e integritetit institucional dhe në rritjen e efikasitetit të procedurave doganore, në funksion të një mjedisi më të favorshëm për tregtinë dhe investimet. Dogana e Kosovës vazhdon të mbetet një partner i besueshëm në zinxhirin ndërkombëtar të tregtisë, e përkushtuar ndaj modernizimit të vazhdueshëm dhe ofrimit të shërbimeve cilësore në mbështetje të zhvillimit ekonomik të vendit.



QEVERIA E PROCEDON NË KUVEND PROJEKTLIGJIN E BUXHETIT PËR VITIN 2026

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 SHKURT - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e parë, të mbajtur të enjten, ka proceduar në Kuvend projektligjin për buxhetin e vitit 2026. Kryeministri Albin Kurti ka thënë se vlera e buxhetit është 4 miliardë euro dhe ka folur me gjerësisht për përmbajtjen e këtij buxheti. "Jemi mbledhur qysh në ditën e parë të punës për të miratuar një listë të marrëveshjeve ndërkombëtare që po e presim për një kohë të gjatë miratimin në kuvend. Në nëntor të vitit të kaluar, Kuvendi i Republikës u shpërnda pa u votuar Plani i Rritjes së Bashkimit Evropian në vlerë prej 882.6 milionë euro dhe tri marrëveshje me Bankën Botërore në vlerë mbi 120 milionë euro, duke rrezikuar përfitimet nga to. Me kuvendin e legjislaturës së 10-të të konstituuar dje dhe me votën tuaj sot, po i japim vendit një mundësi tjetër, për t'i ratifikuar këto marrëveshje ndërkombëtare në Kuvend. E sot, po e riprocedojmë në Kuvend, edhe Projektligjin e Buxhetit për vitin 2026, të cilin e patëm miratuar në mbledhjen e 31 tetorit të vitit të kaluar. Duke mos dashur që t'i përsërisim të gjitha detajet e prezantuar në atë mbledhje, po ndalem vetëm në disa pika të shkurtra, të cilat e karakterizojnë këtë buxhet: Është buxhet me vlerë prej 4 miliardë euro, ku për komunat e Kosovës parashihen 867 milionë



euro. E përmban edhe pagën e 13-të për punëtorët e sektorit publik, që paguhet nga buxheti, pagë, e cila do të paguhet sa po të hyjë në fuqi Ligji i Buxhetit. Përmban edhe ndryshimin e nevojshëm, që mundëson rritjen e shtesës për përvojën e punës nga 0.25 për qind, në 0.50 për qind për 15 vitet e para. Pra, dyfishim i shtesës, që reflekton përvojën e punës", ka thënë Kurti në mbledhjen e qeverisë. Kurti gjithashtu tha se buxheti parashihet edhe shtyrjen e afatit për zbatimin e shkallës progresive të tatimit në pronë, ashtu që ndërkohë ta miratojmë Ligjin e ri të Tatimit në Pronë në konsultim me komunat e vendit tonë. "E pas konstituimit të Kuvendit dhe zgjedhjes së Qeverisë mbrëmë, tash jemi në hapin e tretë, votimi i buxhetit 2026 dhe i marrëveshjeve ndërkombëtare. Porsa të përfundohen këto, jam i gatshëm që nga nesër të fillojmë kontaktet

dhe diskutimet me subjektet tjera politike për çështjen e Presidentit. Si kabinet qeveritar, do të shihemi shumë shpejt në mbledhjet e radhës, në mbledhjet e rregullta të Qeverisë sonë, ku do të përmbushim një nga një zotimet tona, duke filluar me pesë vendimet e para për të cilat jemi zotuar para qytetarëve tanë", ka thënë Kurti.

Shtatë vendimet e para të Qeverisë "Kurti 3"

Miratimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi Aranzhimet për zbatimin e përkrahjes së Unionit për Kosovën në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje. Qëllimi i kësaj marrëveshje është krijimi i bazës së nevojshme ligjore, që Kosova të përfitojë nga fondet e Bashkimit

Evropian, në vlerë prej 882.6 milionë euro, që ofrohen brenda këtij instrumenti për reforma dhe rritje. Miratimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Financimit për Programin e Parë për "Financimin e Politikave Zhvillimore për Efektivitetin Fiskal, Konkurrueshmërinë dhe Rritjen e Gjellbër" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim (pjesë e Bankës Botërore). Miratimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë për "Instrumentin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor" ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian. Marrëveshja ka për qëllim përshpejtimin e përafrimit me legjislacionin e Bashkimit Evropian, integritet ekonomik rajonal, si dhe konvergencën socio-ekonomike me BE-në, duke plotësuar fondet

e instrumentit të para anëtarësimit (IPA). Miratimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin KOMPAS - Qasja Gjithëpërfshirëse e Kosovës për Forcimin e Sistemit të Shëndetësisë. Kjo marrëveshje është mbështetje ndaj sektorit shëndetësor në Kosovë si pjesë edhe e programit qeverisës. Ka vlerën 18.6 milionë euro, dhe kushtet janë të ngjashme sikurse ajo për edukimin në fëmijërinë e hershme. Miratimi i Projektligjit për Ratifikimin e Marrëveshjes së Kredisë ndërmjet Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin "Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesi për Kapitalin Njerëzor të Kosovës. Ministria e Financave bashkë me Bankën Botërore, ka nënshkruar marrëveshjen e kredisë për projektin Edukimi në Fëmijërinë e Hershme dhe Kujdesin për Kapitalin Njerëzor në Kosovë. Miratimi i Projektligjit mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2026, në vlerë prej rreth 4 miliardë euro. Miratimi i kërkesës ndaj Kuvendit, që përmes një vendimi të autorizojë zgjatjen e zbatimit të Ligjit për Ndarjet Buxhetore të vitit të kaluar fiskal, edhe për muajin mars 2026.

Shumica e banorëve në Kosovë jetojnë në banesa në pronësi

PRISHTINË, 12 SHKURT - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar raportin tematik për kushtet dhe organizimin e jetesës sipas komunave. Të dhëna këto të dala nga Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave (ReKos) 2024. Me publikimin e të dhënave për

kushtet dhe organizimin e jetës sipas komunave, përdoruesve u ofrohet një pasqyrë gjithëpërfshirëse mbi nivelin e jetesës së popullsisë në nivel vendi dhe atë lokal. Këto të dhëna përfshijnë informacione mbi: burimet kryesore të mjeteve të jetesës sipas llojit të vendbanimit dhe


komunës, statusin e shfrytëzimit të banesave sipas llojit të vendbanimit dhe komunës, statusin e pronësisë së banesave sipas llojit të vendbanimit dhe komunës, llojin e banesës sipas vendbanimit dhe komunës, si dhe mesataren e numrit të dhomave për anëtar në ekonomitë familjare sipas llojit

të vendbanimit dhe komunës. Sipas të dhënave të dala nga Regjistrimi i Popullsisë (ReKos 2024) sipas statusit të pronësisë së banesave në nivel vendi, del se: pronar ishin 340 016 persona, me qira ishin 19 317 persona, si dhe me shfrytëzim të përkohshëm ishin 7 262 persona.



SI E ÇMONTOI FRIEDRICH NIETZSCHE MORALIN NË ‘GJENEALOGJINË E MORALITETIT’

Si e analizoi Friedrich Nietzsche origjinën e moralit në “Gjenealogjinë e Moralitetit”? Një analizë e thelluar mbi të mirën, të keqen dhe pushtetin



Kur Friedrich Nietzsche botoi në vitin 1887 veprën e tij më provokuese, ai nuk synonte ta përmirësonte moralin, por ta çmontonte atë nga themelet. Në librin Gjenealogjia e Moralitetit, Nietzsche sfidon idenë se e mira dhe e keqja janë kategori universale. Sipas tij, ato janë produkte historike të pushtetit, psikologjisë dhe konfliktit njerëzor.

Ne e ndërtojmë jetën mbi bazën e moralit, por rrallë pyesim: nga vjen ai? A është “e mira” vërtet e mirë, apo një mjet kontrolli?

Nga “Çfarë është e drejtë?” te “Nga vjen morali?”

Filozofët para Nietzsche-s ishin përpjekur të përcaktonin çfarë duhet të jetë morali, qoftë ai i arsyes (si te Kant), apo i dobisë (si te Bentham dhe Mill). Nietzsche e përmbysi pyetjen. Ai nuk pyeti më “Çfarë është e drejtë?”, por “Nga vjen morali?”.

Sipas tij, vlerat nuk janë absolute. Ato janë produkte të marrëdhënieve të pushtetit, të historisë dhe të psikologjisë

kolektive. Kjo është metoda e tij “gjenealogjike”: të analizosh origjinën e një ideje për të kuptuar funksionin e saj real.

Ashtu si evolucioni biologjik shpjegon mbijetesën e specieve, Nietzsche mendonte se edhe vlerat evoluojnë brenda konteksteve shoqërore. Ato nuk zbresin nga qielli; ato lindin nga konflikti.

Morali i zotërinjve dhe morali i skllëvërve

Një nga konceptet më të famshme të Nietzsche-s është ndarja mes dy moraliteteve:

Morali i Zotërinjve

Ky moral lind nga të fortët, aristokratët, luftëtarët, sundimtarët. Për ta “e mira” ishte forca, krenaria, shëndeti, guximi. “E keqja” ishte dobësia dhe dështimi. Heronjtë grekë si Akili përfaqësojnë këtë etikë afirmuese të jetës.

Morali i Skllëvërve

Ky moral lind nga të dobët dhe të shtypurit. Ata e përmbysin sistemin. Dobësia bëhet virtut. Vuajtja bëhet shenjtëri. Përlësia bëhet mirësi.

Sipas Nietzsche-s, ky moral lindi nga një ndjenjë e thellë mërie, një urrëjtje e fshehtë ndaj pushtetit që shndërrohet në sistem vlerash.

Krishtërimi dhe triumfi i moralit të skllëvërve

Nietzsche e pa krishterimin si triumfin përfundimtar të moralit të skllëvërve. Krenaria u kthye në mëkat, fuqia në mizori, vuajtja në shpëtim. Në vend që të nderoheshin heronjtë, morali filloi të nderonte martirët. Dhe ai ngre një pyetje të fortë: A janë vlerat tona vërtet tonat, apo i kemi trashëguar verbërisht?

“Ressentiment” nuk është thjesht zemërim. Është një mëri e akumuluar që nuk

mund të shprehet drejtpërdrejt. Në vend që të sfidojnë të fuqishmit, të dobët krijojnë një sistem moral ku pushteti shpallet mëkat. Kështu lind një përmbysje radikale e vlerave.

Nietzsche argumenton se ndjenja e fajit nuk është natyrore, por historike. Në shoqëritë e hershme, gabimet kompensoheshin me dëmshpërblim. Me kalimin e kohës, ndëshkimi u zhvendos nga jashtë brenda njeriut. Sipas tij, feja dhe normat shoqërore krijuan “ndërgjegjen e keqe”.

Më vonë, edhe Sigmund Freud do të përshkruante një mekanizëm të ngjashëm me konceptin e super-egos, ndërsa Carl Jung do ta shihte konfliktin e brendshëm si mundësi për individin.

Por Nietzsche mbetet kritik: A është faji moral, apo instrument kontrolli?

Vullneti për pushtet kundër vlerave asketike

Nietzsche kritikoi “vlerat asketike”, glorifikimin e


vuajtjes, mohimin e dëshirave dhe nënshtrimin e jetës. Ai propozoi diçka tjetër: vullnetin për fuqi, energjinë krijuese për të tejkaluar veten, për të afirmuar jetën, për të krijuar vlera të reja.

Sipas tij, njeriu i lirë nuk është ai që bindet, por ai që krijon.

Trashëgimia e Nietzsche-s

“Gjenealogjia e Moralitetit” ndikoi thellësisht mbi mendimin modern. Filozofë si Foucault përdorën qasjen gjenealogjike për të analizuar pushtetin dhe institucionet. Psikologjia moderne gjeti paralele në analizën e fajit dhe ndërgjegjes.

Megjithatë, idetë e Nietzsche-s mbeten të debatueshme. Disa i shohin si relativizëm moral. Të tjerë si thirrje për emancipim. Por pyetja e tij mbetet aktuale: Pse i besojmë vlerave vetëm sepse janë të vjetra? / bota.al



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

West Hami nuk heq dorë nga Albion Rrahmani

LONDËR, 12 SHKURT - Interesimi i West Ham Unitedit muaj më parë për Albion Rrahmani nuk ishte spekulim, pasi skuadra angleze nuk ka hequr dorë ende nga sulmuesi i Kosovës. Është bërë me dije se West Hami po e monitoron

Rahmanin, përpara se të bëjë një ofertë zyrtare për transferimin e tij në verë. Skautët e West Hamit po insistojnë se sulmuesi 25-vjeçar është investim i qëlluar, sidomos pas largimit të anglezit Callum Wilson, të

cilit i skadon kontrata në fund të sezonit. Rrahmani është pjesë e Spartës së Pragës prej vitit 2024 kur iu bashkua nga Rapidi i Bukureshtit, ndërsa kartoni i tij vlerësohet mbi 7 milionë euro. Në 34 paraqitje këtë

sezon për ekipin nga Çekia në të gjitha garat, Rrahmani ka shënuar 13 gola dhe ka bërë 2 asistime. Krahas West Hamit, interesim për Rrahmanin gjatë afatit kalimtar të dimrit pati shprehur edhe ekipi i njohur nga Franca, Lyoni.



ADEMI MERR PJESË NË KONGRESIN E 50-të TË UEFA-S: U MORËN VENDIME TË RËNDËSISHME PËR FUTBOLLIN

BRUKSEL, 12 SHKURT - Presidenti i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka marrë pjesë në Kongresin e 50-të të UEFA-s në Bruksel. Ademi ka bërë me dije se në këtë kongres janë marrë vendime të rëndësishme, të cilat dëshmojnë përkushtimin e vazhdueshëm të UEFA-s ndaj forcimit të integritetit, transparencës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të futbollit në të gjitha nivelet.

“Së bashku me nënkryetarin Bakir Burri dhe sekretarin e përgjithshëm, Markus Weidner morëm pjesë në Kongresin e 50-të të UEFA-s në Bruksel. Në këtë ngjarje me rëndësi të veçantë për zhvillimin, qeverisjen dhe të ardhmen e futbollit evropian

pati diskutime konstruktive dhe u morën vendime të rëndësishme, të cilat dëshmojnë përkushtimin e vazhdueshëm të UEFA-s ndaj forcimit të integritetit, transparencës dhe zhvillimit të qëndrueshëm të futbollit në të gjitha nivelet”, ka shkruar Ademi në “Facebook”.

Ai ka thënë se bashkëpunimi ndërinstitucional dhe vizioni i përbashkët janë thelbësorë për përbashkëtimin e sfidave dhe shfrytëzimin e mundësive që ofron futboll modern.

“Ndryshimet në garat evropiane në nivel klubesh, zhvillimi i futbollit të vajzave, reformat në qeverisjen e mirë me fokus te qëndrueshmëria, partneriteti dhe projektet me përgjegjësi



sociale ishin vetëm disa nga temat që u diskutuan. Federata jonë mbetet e përkushtuar të kontribuojë aktivisht në vizionin,

politikat dhe iniciativat e UEFA-s, me synimin për të avancuar standardet organizative, sportive dhe zhvillimore, si dhe për të

ndërtuar një futboll më të fortë, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm”, ka shkruar Ademi.

ADEMI MERR MBËSHTETJE NGA PRESIDENTI I FIFA-S PËR ZHVILLIMIN E FUTBOLLIT NË KOSOVË

Gjatë qëndrimit në Bruksel, presidenti i FFK-së, Agim Ademi është takuar me presidentin e FIFA-s, Gianni Infantino, i cili e ka përgëzuar për mandatin e ri në krye të FFK-së. Krashas kësaj, Ademi ka marrë mbështetje nga Infantino për zhvillimin e futbollit në Kosovë. “Në një bisedë miqësore dhe konstruktive, presidenti Infantino më përgëzoi për mandatin e ri, duke shprehur mbështetjen e tij dhe gatishmërinë për të thelluar bashkëpunimin në funksion të zhvillimit të futbollit në Kosovë. Është gjithmonë inkurajuese të kesh partnerë me vizion të përbashkët, të cilët besojnë në



projekte konkrete dhe në fuqinë që ka futbollit për të bashkuar njerëzit. Mbështetja e FIFA-s ka qenë dhe mbetet thelbësore për avancimin e infrastrukturës,

programeve zhvillimore dhe rritjen e standardeve në futbollin tonë. Mbështetja unanime në Kuvendin Zgjedhor të FFK-së është një dëshmi e unitetit brenda komunitetit tonë të futbollit, një unitet ky që përkon edhe me moton e FIFA-s: ‘Football Unites the World’. Ky besim na obligon të punojmë edhe më shumë për ta ngritur futbollin kosovar në nivele edhe më të larta. Falënderoj presidentin Infantino për përkrahjen dhe respektin ndaj Federatës së Futbollit të Kosovës dhe Republikës së Kosovës. Vazhdojmë bashkë, me përgjegjësi e krenari!”, ka shkruar Ademi.

FUTBOLLISTJA AMERIKANE VJEN PËR TË LUAJTUR NË KOSOVË, FIRMOS ME KFF MITROVICA

MITROVICË, 12 SHKURT - Skuadra kosovare, KFF Mitrovica ka mbyllur afatin e transferimeve me një “goditje” nga Amerika. Mitrovicasit kanë transferuar futbollisten amerikane, Ryann Fetty. Ajo vjen nga skuadra e Bundesliga 2 në Austri, Pinzgau Saalfelden. “KFF Mitrovica mbyll merkaton e transferimeve me përforsimin e radhës, duke zyrtarizuar afrimin e lojtares amerikane Ryann Fetty, e cila së fundmi ishte pjesë e 2. Frauen-Bundesliga (liga e dytë e Austrisë) me klubin FC Pinzgau Saalfelden. Me vetëm 10 ditë të



mbetura deri në fillimin e kampionatit, klubi ynë është gati për një start të ri, me objektiva të qarta dhe ambicioze drejt mbrojtjes së titullit kampion”, ka njoftuar KFF Mitrovica.

Tuchel do të mbetet trajner i Anglisë deri në vitin 2028

LONDËR, 12 SHKURT - Thomas Tuchel pritet ta zgjasë kontratën e tij si trajner i Anglisë deri në vitin 2028, me një njoftim që mund të vijë para shortit të Ligës së

Kombeve. Gjermani është i etur ta udhëheqë Anglinë përtej Kupës së Botës të kësaj vere dhe në Euro 2028, i cili do të mbahet në Mbretërinë e

Bashkuar dhe Irlandë, me fazat e fundit në Wembley. Kontrata e tij aktuale është deri në fund të Kupës së Botës 2026, por FA dëshiron qartësi dhe stabilitet përpara

turneut. Nën udhëheqjen e tij, Anglia u kualifikua për Kupën e Botës me një rekord të përsosur, dhe lojtarët e lartë kanë vlerësuar ndikimin e tij.





NDËRMARRJA
PUBLIKE
BANESORE

Adr: Rr. "Zija Shemsiu", nr.22, Ulpianë - Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 606 670; +383 (0) 38 606 672; 0800 11 672
e-mail: mirembajtja@npbanesore.com; info@npbanesore.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Rregullores për Procedurat e Punësimit Nr. Protokolli 01-893/2, datë 29 Tetor 2024 dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës Nr. Protokolli 01-336/2, datë 11 Mars 2025, Ndërmarrja Publike Banesore Sh.A në Prishtinë, shpall:

KONKURS
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e i/e për Zhvillim dhe Monitorim Strategjik 1(një) pozitë.
I raporton: Menaxherit/es të/së Departamentit për Zhvillim dhe Planifikim Strategjik

Niveli i pagës:: 6.1

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të pacaktuar (puna provuese 3 muaj)

Vendi Punës: Rr. "Zija Shemsiu" nr. 22, Ulpianë- Prishtinë (selia e Ndërmarrjes Publike Banesore)

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Monitoron dhe vlerëson planet dhe aktivitetet e Departamenteve konform Planit të biznesit dhe Strategjisë zhvillimore;
- Zhvillon planet strategjike dhe operacionale;
- Dizajnon dhe mirëmbanë sistemin për menaxhim te monitorimit dhe vlerësimit, format raportuese, udhërrëfyesit dhe dokumentet përkrahëse;
- Ofron ndihmë për implementimin e strategjive;
- Të ndërmarr vizita në terren, vizita kontrolluese dhe intervista për monitorim të shërbimeve të ofruara në nivel të NPB-së;
- Ndërmerr aktivitete monitoruese dhe vlerësuese për të vlerësuar performancën përkundër planeve formale;
- Zhvillon, implementon dhe monitoron një strategji të kualitetit dhe planifikimit duke përfshirë procedurat për kontroll të kualitetit, masat e performancës dhe standardet e shërbimeve;
- Zyrtari për Monitorim dhe Vlerësim është përgjegjës për të punuar ngushtë me menaxherët projekteve që të arrijnë monitorim efektiv, vlerësim, vlerësim të ndikimit, rishikim dhe raportim të rezultateve të punës;
- Raporton për punët e kryera te udhëheqësi i Departamentit duke përgatit raportet e punës në baza ditore, javore, mujore, vjetore për punën që është ngarkuar;
- Mbikëqyrësi i Departamentit mund ta ngarkojë me detyra të tjera sipas nevojave të NPB-së;
- Ne rast mungese të punonjësve tjerë, me urdhër te mbikëqyrësit mund ta zëvendësojë dhe të kryej detyra tjera;
- Kryen edhe detyra tjera që ndërlidhen me përshkrimin e detyrave te punes, si dhe detyrave të ngarkuara nga menaxhmenti.

Kualifikimet:

- Diplomë universitare;
- 1 vit përvojë pune;
- Preferohen kurse dhe trajnime tjera gjatë karrierës profesionale.

Aftësitë:

- Aftësi të larta analitike dhe organizative;
- Aftësi për t'iu përshtatur prioriteteve, kërkesave, afateve kohore;
- Aftësi komunikimi dhe bashkëpunimi;
- Shkathtësi kompjuterike në Microsoft Office;
- Njohje e sektorit publik lokal/qendror.

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet në mënyrë elektronike në adresën: burimet.njerezore@npbanesore.com. Të gjitha dokumentet duhet të jenë të bashkëngjitura në programin PDF.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPB-së;
- Dëshmia e Diplomës Universitare;
- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 1 vit;
- Dëshmia për kurse dhe trajnime (e preferushme);
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Çertifikatën mjekësore që është në gjendje të mirë shëndetësore si fizike ashtu dhe psikike para nënshkrimit të kontratës (vetëm kandidati/ja i/e përzgjedhur)

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Ndërmarrja Publike Banesore ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Njoftim PËR PRIVATËSINË DHE PËRPUNIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Ndërmarrja Publike Banesore SHA Prishtinë – NPB SHA Prishtinë, me seli në Prishtinë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, informon kandidatët për punën lidhur me përpunimin e të dhënave personale gjatë procesit të rekrutimit.

1. Qëllimi i përpunimit:

Të dhënat personale përpunohen me qëllim të:

- Zhvillimit të procedurës së rekrutimit dhe përzgjedhjes;
- Verifikimit të kualifikimeve profesionale;
- Ushtrimit të së drejtës së ankesës;
- Themelimit të marrëdhënies së punës për kandidatët e përzgjedhur.

2. Llojet e të dhënave që përpunohen:

- Të dhënat identifikuese (emër, mbiemër, datëlindje, numri personal);
- Të dhënat e kontaktit;
- Të dhënat mbi arsimin dhe përvojën profesionale;
- Dokumentet mbështetëse të aplikimit;
- Të dhëna të tjera të kërkuara sipas konkursit.

3. Baza ligjore:

Përpunimi i të dhënave personale bëhet në përputhje të plotë me:

- Ligjin Nr. 06–L/062, datë 30 Janar 2019, Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale¹;
- Ligjin Nr. 03/L–212, datë 01 Nëntor 2010, I Punës².
- Ligjin Nr. 03/L–087, datë 13 Qershor 2008, Për Ndërmarrjet Publike³, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L–111, datë 20 Prill 2012⁴ dhe Ligjin Nr. 05/L–009, datë 07 Prill 2015⁵;
- Rregulloren Për Mbrojtjen e të Dhënave⁶ në NPB SHA Prishtinë, si dhe aktet nënligjore të brendshme.

4. Afati i ruajtjes:

- Të dhënat personale të kandidatëve që me vullnetin e tyre nuk i nënshtrohen procedurës së rekrutimit pjesërisht apo në tërësi, ruhen deri në tridhjetë (30) ditë, nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat personale të kandidatëve të papërzgjedhur ruhen deri në një (1) vit nga përfundimi i procedurës së rekrutimit.
- Të dhënat e kandidatëve të përzgjedhur ruhen në dosjen personale gjatë marrëdhënies së punës dhe më pas sipas legjislacionit arkivor.

5. Qasja dhe siguria.

Të dhënat personale përpunohen vetëm nga persona të autorizuar dhe mbrohen me masa teknike dhe organizative të përshtatshme.

6. Të drejtat e kandidatëve:

Kandidatët kanë të drejtë:

Të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre;

Të kërkojnë qasje në të dhënat e tyre, korrigjim ose fshirje të tyre sipas ligjit;

Të paraqesin ankesë pranë Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Kontakti:

Për pyetje lidhur me përpunimin e të dhënave personale, kandidatët mund të kontaktojnë:

NPB SHA Prishtinë – Divizioni i Burimeve Njerezore.

📍 **Lagje** "ULPIANA", **Rr.** "Zija SHEMSIU", **Nr.** 22, 10000, Prishtinë.

✉ burimet.njerezore@npbanesore.com

mbrojtjaetedhenave@npbanesore.com

Shpallja është e hapur që nga data 13.02.2026 deri më 27.02.2026 në ora 23:59.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në Divizionin e Burimeve Njerezore të Ndërmarrjes Publike Banesore në nr. tel.: 038 553 311.

Na osnovu odredbi člana 8. Zakona o radu, Pravilnika o postupcima zapošljavanja br. Protokol 01-893/2 od 29. oktobra 2024. godine i Pravilnika o sistematizaciji radnih mesta br. Protokol 01-336/2 od 11. marta 2025. godine, Javno stambeno preduzeće AD u Prištini objavljuje:

KONKURS

Za popunjavanje radnog mesta

Naziv radnog mesta: Službenik za strateški razvoj i praćenje 1 (jedno) radno mesto.

Izveštava: Rukovodiocu Odeljenja za razvoj i strateško planiranje

Nivo plate: 6,1

Radno vreme: 40 sati nedeljno

Trajanje ugovora: Neodređeno (probni period od 3 meseca)

Mesto rada: Ul. „Zija Šemsiu“ br. 22, Ulpjana - Priština (sedište Javnog stambenog preduzeća)

Dužnosti i odgovornosti:

- Prati i procenjuje planove i aktivnosti odeljenja u skladu sa Poslovnim planom i Strategijom razvoja;
- Razvija strateške i operativne planove;
- Dizajnira i održava sistem upravljanja praćenjem i evaluacijom, obrasce za izveštavanje, smernice i prateću dokumentaciju;
- Pruža pomoć u sprovođenju strategija;
- Obavlja terenske posete, kontrolne posete i intervjuje radi praćenja usluga koje se pružaju na nivou Javnog stambenog preduzeća;
- Obavlja aktivnosti praćenja i evaluacije radi procene učinka u odnosu na formalne planove;
- Razvija, sprovodi i prati strategiju i planiranje kvaliteta, uključujući procedure kontrole kvaliteta, mere učinka i standarde usluga;
- Službenik za praćenje i evaluaciju je odgovoran za blisku saradnju sa rukovodiocima projekata kako bi se postiglo efikasno praćenje, evaluacija, procena uticaja, pregled i izveštavanje o rezultatima rada;
- Izveštava o obavljenom radu šefa odeljenja pripremom izveštaja o radu na dnevnom, nedeljnom, mesečnom i godišnjem nivou za dodeljeni posao;
- Rukovodilac odeljenja može mu/joj dodeliti druge zadatke u skladu sa potrebama Javnog stambenog preduzeća;
- U slučaju odsustva drugih zaposlenih, po nalogu rukovodioca, može ga/je zameniti i obavljati druge zadatke;

Obavlja i druge poslove vezane za opis posla, kao i poslove koje mu dodeli rukovodstvo.

Kvalifikacije:



- Univerzitetska diploma;
- 1 godina radnog iskustva;
- Poželjni su drugi kursevi i obuke tokom profesionalne karijere.

Veštine:

- Visoke analitičke i organizacione sposobnosti;
- Sposobnost prilagođavanja prioritetima, zahtevima, rokovima;
- Komunikacione i saradničke veštine;
- Veštine rada na računaru u Microsoft Office-u;
- Poznavanje lokalnog/centralnog javnog sektora.

Način prijavlјivanja:

Prijava se podnosi elektronski na adresu: brukës.njerezore@npbanesore.com. Sva dokumenta moraju biti priložena u PDF formatu.

Kandidati koji se prijavljuju moraju pravilno navesti adresu, kontakt telefon i imejl adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na ostale postupke zapošljavanja.

Dokumenta koja treba priložiti:

- Prijava za NPB;
- Dokaz o univerzitetskoj diplomi;
- Dokaz o radnom iskustvu od najmanje 1 godine;
- Dokaz o kursovima i obukama (preporučuje se);
- Uverenje o krivičnom dosijeu izdato od strane suda, kojim se dokazuje da niste osuđivani ili da niste pod istragom (ne sme biti starije od šest meseci);
- Kopija lične karte;
- Lekarsko uverenje da ste u dobrom fizičkom i mentalnom zdravlju pre potpisivanja ugovora (samo za izabrane kandidate)

Napomena: Prijave koje stignu nakon roka navedenog u konkursu i one koje su nepotpune sa relevantnom dokumentacijom neće biti razmatrane.

Javno stambeno preduzeće nudi jednake mogućnosti zapošljavanja svim građanima Republike Kosovo i prima prijave svih osoba oba pola i iz svih zajednica u Republici Kosovo.

OBAVEŠTENJE O PRIVATNOSTI I OBRADI LIČNIH PODATAKA

Javno stambeno preduzeće SHA Priština – NPB SHA Priština, sa registrovanim sedištem u Prištini, u svojstvu kontrolora ličnih podataka, obaveštava kandidate o radu vezanom za obradu ličnih podataka tokom procesa zapošljavanja.

1. Svrha obrade: - Lični podaci se obrađuju u svrhu:

- Razvoja postupka zapošljavanja i selekcije;
- Provere stručnih kvalifikacija;
- Korišćenja prava na žalbu;

Uspostavljanje radnog odnosa za izabrane kandidate.

2. Vrste podataka koji se obrađuju: Identifikacioni podaci (ime, prezime, datum rođenja, lični broj), Kontakt podaci, Podaci o obrazovanju i stručnom iskustvu, Prateća dokumentacija, uz prijavu, Ostali podaci koje zahteva konkurs.

3. Pravni osnov:

Obrada ličnih podataka vrši se u potpunosti u skladu sa:

- Zakonom br. 06–L/062, od 30. januara 2019. godine, o zaštiti ličnih podataka;
- Zakonom br. 03/L–212, od 1. novembra 2010. godine, o radu.
- Zakonom br. 03/L–087, od 13. juna 2008. godine, o javnim preduzećima, kako je izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L–111, od 20. aprila 2012. godine i Zakonom br. 05/L–009, od 7. aprila 2015. godine;
- Pravilnik o zaštiti podataka u NPB SHA Priština, kao i interni podzakonski akti.
- 4. Period čuvanja: Lični podaci kandidata koji dobrovoljno ne prođu kroz postupak regrutacije delimično ili u celosti čuvaju se do trideset (30) dana od završetka postupka regrutacije.
- Lični podaci neizabranih kandidata čuvaju se do jedne (1) godine od završetka postupka regrutacije.
- Podaci izabranih kandidata čuvaju se u ličnom dosijeu tokom radnog odnosa i nakon toga u skladu sa arhivskim propisima.
- 5. Pristup i bezbednost- Lične podatke obrađuju samo ovlašćena lica i zaštićeni su odgovarajućim tehničkim i organizacionim merama.

6. Prava kandidata:

Kandidati imaju pravo da:

Budu obavešteni o obradi svojih podataka;

Zahtevaju pristup svojim podacima, ispravku ili brisanje u skladu sa zakonom;

Podnesu žalbu Agenciji za informacije i privatnost.

Kontakt: Za pitanja u vezi sa obradom ličnih podataka, kandidati mogu kontaktirati:

NPB SHA Priština – Odeljenje za ljudske resurse. Naselje „ULPIANA“, ulica „Zija ŠEMSIU“, br. 22, 10000, Priština.

brëtër.njerezore@npbanesore.com

mbrojtjaetedhenave@npbanesore.com

Oglas je otvoren od 13.02.2026. do 27.02.2026. u 23:59.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati Odeljenje za ljudske resurse Javnog stambenog preduzeća na broj telefona: 038 553 311.

Adresa: Rr. “Zija SHEMSIU”, Nr. 22, Prishtinë. Nr. Tel. +383 (0) 38/606–672; 0800/11–672.

E-mail: info@npbanesore.com; WEB: <https://npbanesore.com>

Faqe 6 nga 6

THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania “MALI-Q” Sh.p.k. kërkon një ofertues/kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizim me paisje si më poshtë:

1. Homogjenizator
2. Seperator
3. Kada djathi
4. Printer indistrial
5. Pompa thithëse
6. Mikser për gjalpë
7. Matës qumshti

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi “MALI Q” sh.p.k. nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.

Ftesat për Kuotim mund të merren më së largu deri me 19 Shkurt 2026.

Përfituesi: Kompania “MALI-Q” sh.p.k.

Adresa: Lloshkobare -Ferizaj

Telefoni: +383(44) 647 592

E-maili: shpkmali@gamail.com

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 28 Shkurt 2026

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “MEDIZIN PERSONAL RECRUITING” SH.P.K. me seli në Mitrovicë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 812208131dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “MEDIZIN PERSONAL RECRUITING” D.O.O. Mitrovica donelo odluku o prestani rada sa nrb. 812208131ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlјivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “MEDIZIN PERSONAL RECRUITING” L.L.C. with headquarters Mitrovica, has come to the decision to quit its business: 812208131the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Guri i Bekuar” Sh.p.k., Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për impiantin për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë në Z.K. Seqishtë, Hani i Elezit.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 03.04.2026 në ora 10:00 në Sh.F.M.U. “Ilaz Thaçi”, Hani i Elezit, do të organizohet debat publik nga Kompania “Guri i Bekuar” Sh.p.k., Hani i Elezit, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Guri i Bekuar” Sh.p.k., Hani i Elezit, për Pëlqim Mjedisor për impiantin për përpunimin, thërrmimin dhe seperimin e gurit të fortë në Z.K. Seqishtë, Hani i Elezit.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 16, pika 4, Kompania “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Komuna Pejë, në bashkëpunim me Ministrin e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe komunën organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për zgjerimin e zonës së eksploatimit të inerteve në lokalitetin Gllaviçicë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 02.04.2026 në ora 11:00 në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Zef Serembe”, fshati Gllaviçicë, Komuna Pejë, do të organizohet debat publik nga Kompania “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Komunën.

Debati Publik do të organizohet edhe në mënyrë virtuale në platformën online:

<https://us05web.zoom.us/j/7012651943?pwd=JsyiMPR68piZDwwrm2Z53eU1x9TEbu.1>

Meeting ID: 701 265 1943

Passcode: 123456

Në linkun e mëposhtëm mund të gjeni raportin e VNM-së për Kompaninë “Vranina” Sh.p.k., Gllavaçicë, Pejë, për Pëlqim Mjedisor për zgjerimin e zonës së eksploatimit të inerteve në lokalitetin Gllaviçicë, Pejë.

<https://mmphi.rks-gov.net/Document/Announcements?type=2>

Në emalin e mëposhtëm mund të dërgoni komentet lidhur me projektin

ynm.komente@rks-gov.net

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon ne implementimin e projektit.

THIRRJE PËR APLIKIM

Kompania “MALI-Q” Sh.p.k. kërkon një ofertues/kontraktor apo kompani të interesuar dhe të kualifikuar që të dorëzojë një ofertë/propozim për furnizim me paisje si më poshtë:

1. Homogjenizator
2. Seperator
3. Kada djathi
4. Printer indistrial
5. Pompa thithëse
6. Mikser për gjalpë
7. Matës qumshti

Kompanitë e interesuar duhet të kontaktojnë direkt te përfituesi “MALI Q” sh.p.k. nëpërmjet e-mailit apo telefonit, për të kërkuar një Ftesë për Kuotim tek adresa e cekur më poshtë.

Ftesat për Kuotim mund të merren më së largu deri me 19 Shkurt 2026.

Përfituesi: Kompania “MALI-Q” sh.p.k.

Adresa: Lloshkobare -Ferizaj

Telefoni: +383(44) 647 592

E-maili: shpkmali@gmail.com

Ofertat/propozimet duhet të dorëzohen tek adresa e përfituesit më së largu deri me 28 Shkurt 2026

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- “Diellzapharm” SH.P.K. shpall të pavlefshme numrin e biznesit 811466037 të lëshuar nga ATK e Kosovës.

- Violeta Hoda shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” në Gjakovë.

- Gasper Doci shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Miriman Krasniqi shpall te pavlefshme 2 dëftesat shme “ Ymer Prizreni” Prizren.

- Blerta Leku shpall te pavlefshme diplomën QK “11 Marsi” Prizren.

- Nerxhivane Shabani shpall te pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të lartë të Gjmnazit “Frang Bardhi”.

- Florian Gllareva shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Dëshmoret e Fortesës” Verboc Drenas.

- Enis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.
- Denis Çoçaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Zenun Çoçaj”.

- Andi Rezniqui shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme ekonomike “Kadri Kusari” Gjakovë.

- Osman Gjigja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Shaban Golaj” Lipovec Gjakovë.

- Arifqe Gutaj shpall të pavlefshme dëftesën e sh.m.u të gjmnazit “Gjon Buzuku” Prizren.

- Maurita Koca nga Bishtazhini KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të Gjmnazit “Hajdar Duishi” Gjakovë.

- Bedri Zeneli nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën dhe certifikatën e notave të Gjmnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1906

Columbus, Georgia, USA
Since 1906 0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

